


ÇOHU!

REFORMA NË FUSHËN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL



Zbatimi i
Marrëveshjes së
Stabilizim Asociimit
(MSA) dhe Agjendës
për Reforma
Evropiane (ERA) për
vitin 2018



REFORMA NË FUSHËN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL



Zbatimi i
Marrëveshjes së
Stabilizim Asociimit
(MSA) dhe Agjendës
për Reforma
Evropiane (ERA) për
vitin 2018





“Ky projekt është financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”

Përpiluar nga:

Florie Xhemajli

Asistente në monitorim:

Albana Krasniqi dhe Leonida Molliqaj

Lekturoi:

Besa Kalaja

Origjinali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

Rruga: UÇK 25-1; Prishtinë, Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

www.cohu.org

E drejta autoriale © 2019 nga Organizata Çohu! Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.



PËRMBAJTJA

1. Hyrje	6
2. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Agjenda për Reforma Evropiane: Fokusi në Arsimin dhe Aftësimin Profesional	7
2.1 Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2018-2022.....	8
2.2 Plani për zbatimin e Agjendës Evropiane për Zhvillim ERA	9
3. Rezultatet e zbatimit të MSA-së për arsimin dhe aftësimin profesional.....	10
3.1 Zbatimi i Agjendës Evropiane për Zhvillim ERA për Arsimin dhe Aftësimin Profesional	12
4. Analizë e masave të inicuar dhe ndikimit në institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional	13
4.1 Harmonizimi i legjislacionit dhe Iniciativa për formën duale të arsimit.....	13
4.2 Standardet e profesionit, rishikimi dhe zbatimi i kurrikulave	15
4.3 Menaxhimi dhe financimi i IAAP.....	17
4.4 Stereotipet në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional	19
5. Rekomandime	22

1. HYRJJE

Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) është i një rëndësie të lartë për shkak të lidhjes së ngushtë me punësimin e rrjedhimisht edhe me mirëqenien sociale dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Në këtë zinxhir, roli i Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) është i rëndësishëm në pajisjen e nxënësve me shkathësi dhe kompetenca që i përgjigjen kërkesave në tregun e punës. Përkundër rëndësisë, AAP mbetet një fushë me probleme të theksuara dhe konsiderohet se shkathësitë e fituara dhe kapacitetet që ofrojnë institucionet e AAP-së nuk janë në harmoni me kërkesën në tregun e punës.

Duke marrë parasysh që fusha e AAP-së është mjaft komplekse nënkupton që për reformimin e kësaj fushe implikohen një numër i madh i institucioneve. Poashtu, lidhja e pashmangshme me tregun e punës si dhe roli kyq i sektorit të biznesit në vetë reformimin e fushës së AAP-së e vështirësojnë këtë proces edhe më tej, pasi që kemi të bëjmë me një vend me zhvillim të ulët ekonomik.

Në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) mbi strukturën e ndërmarrjeve thuhet se numri i ndërmarrjeve të orientuara në prodhim është vetëm 13.7% dhe se profili i ndërmarrjeve që mbizotëron në Kosovë është sektori i tregtisë, e në tregti mbizotëron importi me 89%.¹ Poashtu në bazë të të dhënave vërehet se 96.2 % e bizneseve të regjistruara në vitin 2018 ishin biznese të vogla 1 deri në 4 të punësuar.² Shkalla e papunësisë vazhdon të mbetet tejet e lartë me 29.6% në vitin 2018.³

Papunësia vazhdon të mbetet e lartë kryesisht për gratë ku vetëm 12.3% e grave janë të punësuar. Pak gjasa punësimi ka edhe për të rinjtë (15-24 vjeç) papunësia e të cilëve arrin shifrën 55.4%.⁴

Nga e tërë kjo mund të kuptojmë se kemi të bëjmë me ndërlidhjen e dy sektorëve me probleme të mëdha si arsimit dhe bizneset dhe njëkohësisht me ndikim të pashmangshëm që këto dy fusha kanë mbi njëra-tjetrën.

Fushës së AAP-së rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe në marrëveshjet e nënshkruara me Bashkësinë Evropiane, strategjitë kombëtare për zhvillimin e arsimit si dhe në planet e hartuara për zbatimin e këtyre planeve dhe marrëveshjeve. Prandaj, ky raport është i fokusuar në monitorimin e zbatimit të masave dhe veprimeve të planifikuara në fushën e AAP-së për vitin 2018. Fokusi i këtij monitorimi janë zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) në fushën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional, përkatësisht monitorimi i planeve për zbatimin e këtyre dy marrëveshjeve të cilat korrespondojnë me njëra tjetrën në fushën e AAP-së.

Për të kuptuar një hap më tej zbatimit apo mungesën e zbatimit të masave të planifikuara për AAP dhe zbatimin të marrëveshjeve, monitorimi shtrihet edhe në të kuptuarit e rolit, ecurisë dhe ndikimit të këtyre reformave në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional.

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raporti Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM2 2018: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm2-2018>

2 Ibid

3 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2019, faqe 71: <http://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>

4 Ibid

2. MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT (MSA) DHE AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE: FOKUSI NË ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit si marrëdhënie kontraktuale në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian përcakton mekanizmat dhe afatet për zbatimin e reformave që qojnë drejt përafritit të Kosovës me BE-në. Fushëveprimi i kësaj marrëveshje është tejet i gjerë dhe përfshinë përveç çështjeve politike dhe juridike edhe të gjitha sferat e qeverisjes. Kjo formë bashkëpunimi dhe këto reforma janë të lidhura me fushat prioritare të Acquis⁵ të Bashkimit Evropian ku shtetet candidate për anëtarësim në BE, në këtë rast edhe Kosova, duhet ta pranojnë Acquis dhe të sigurojnë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së.

Për të zbatuar reformat dhe përmbushur obligimet që dalin nga kjo marrëveshje kontraktuale Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2016 harton Program Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). Në bazë të këtij programi përcak-

tohen prioritetet afatmesme për zbatimin e reformave të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes si dhe harmonizimin e legjislacionit me atë të Acquis të BE-së. Rrjedhimisht edhe prioritetet afatmesme për Arsimin dhe Aftësimin profesional janë pjesë e këtij programi.⁶ Për të përcaktuar prioritetet afatshkurtra për zbatimin e MSA-së u zhvillua Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) e cila vë prioritet mbi tri fusha kryesore si: (I) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, (II) konkurrueshmëria dhe klima e investimeve, dhe (III) arsimi dhe punësimi.

Pra, janë dy korniza të hartimit të politikave që shërbejnë si bazë për zbatimin e MSA-së : Programi për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe Agjenda për Reforma Evropiane (ERA), ku e para, PKZMSA, shërben si kornizë ombrellë, ndërsa ERA shërben si dokument më specifik që përmban prioritetet afatmesme dhe masa afatshkurtra. PKZMSA përtrihet për çdo vit në mënyrë

⁵ Acquis është organi i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të BE-së: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en

⁶ Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA 2018-2022: http://www.mei-ks.net/repository/docs/20180731115427_1_pkzmsa_2018-2022_final_miraturar nga_kuvendi.pdf

që të përshtatet sa më mirë me ecurinë e reformave. Përveç këtyre, si bazë për reformat dhe zhvillimin në arsim dokument bazë mbetet Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Monitorimi në vazhdim është i koncentruar pikërisht në këto dokumente, më saktësisht në masat dhe veprimet e parapara për vitin 2018 për arsimin dhe aftësimin profesional.

Duke qenë se i tërë dokumenti PZKMSA është i ndarë në tri blloqe: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike, dhe Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquisnë e BE-së; atëherë masat që janë relevante për arsimin dhe aftësimin profesional bien në kuadër të dy blloqeve të fundit si rezultat i lidhjes së pashmangshme të AAP-së me tregun e punës dhe politikatat ekonomike në përgjithësi.

2.1 Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2018-2022

Sa i përket reformave në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, që është temë bazë e këtij monitorimi, ato janë të parapara në kuadër të Nenit 107 Arsimit dhe Trajnimit të MSA-së. Synimi bazë i kësaj reforme është ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe aftësimit profesional, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë, si mënyrë për të nxitur zhvillimin e aftësive, punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Në kuadër të kësaj reforme po ashtu synohet qasje gjithëpërfshirëse dhe mënjanim i çfarëdo forme diskriminuese.

Në Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2018 masat që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional janë paraparë në: pikën 3.27 Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimit dhe kultura dhe pikën 2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit. Masat e monitoruara për AAP përhijnë 1 masë nën-ligjore dhe 2 masa që kanë të bëjnë me reformat institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe që të trija lidhen direkt me Nenin 107 të MSA-së. Masat janë si vijon:

1

UA për kushtet dhe kriteret që drejton themelimin e formave duale të Arsimit dhe aftësimit profesional, në të cilën aftësimi paraprak dhe përvoja realizohen në ndërmarrje (plotësim ndryshim)

2

Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave- Kurrikulat të AAP për 20 profile të rishikuara dhe 40 trajnerë dhe mësimdhënës bazuar në kurrikulën bërthamë, të trajnuar - K3 2018

3

Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave- 25 standarde të profesionit të cilat verifikohen nga AKK, të hartuara – MASHT

2.2 Plani për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane ERA

Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) vë prioritet mbi tri fusha kryesore si: (I) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, (II) konkurrueshmëria dhe klima e investimeve, dhe (III) arsimit dhe punësimi. Për fushën e tretë të këtij dokumenti, arsimit dhe kultura, janë përcaktuar edhe prioritetet afatmesme dhe të menjëhershme që duhet të ndërmerren. Plani i Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve Kyçe të kësaj fushe parasheh një varg masash dhe veprimesh sa i përket Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Pika 3.6 e këtij plani ka për prioritet përmirësimin e cilësisë së Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë dhe në kuadër të saj janë përcaktuar një varg veprimesh si vijojnë:

- Kjo formë bashkëpunimi dhe këto reforma janë të lidhura me fushat prioritare të Asquis të Bashkimit Evropian ku shtetet candidate për anëtarësim në BE, në këtë rast edhe Kosova, duhet ta pranojnë Asquis dhe të sigurojnë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së.

a.1 Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (e bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë.

a.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësimin profesional përmes harmonizimit të AAP –së me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës

a.3 Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP-në dhe fillimi i fazës së pilotimit

a.4 Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së

b.1 Përmirësimi i rezultateve të arsimin dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore

3. REZULTATET E ZBATIMIT TË MSA-SË PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL

Tri masa u monitoruan në kuadër të PKZMSA-së për arsimin dhe aftësimin profesional. Sipas Raportit mbi Zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2018 asnjëra nga masat që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional nuk është plotësuar.

Në të tri masat e planifikuara institucion bartës ishte Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë MASHT ku në dy prej tyre institucione ndihmëse ishin Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale MPMS si dhe Agjencioni Kosovar i Kualifikimeve AKK. Në përgjithësi MASHT figuron në treshen e fundit të institucioneve me performancë të ulët në zbatimin e PKZMSA për vitin 2018 me vetëm 42.11% (8 / 19 masa të zbatuara), përderisa MPMS është vlerësuar si institucioni më i suksesshëm në zbatimin e këtij plani me 100% zbatueshmëri (10/10 masa të zbatuara).⁷

Masat e planifikuara për vitin 2018 janë në kuadër të masave në pikën 3.27 Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura, pikën 2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit. Raporti për zbatimin e PKZMSA 2018 thekson se në përgjithësi të dy këto pika që kanë të bëjnë me reformat në arsim kishin zbatueshmëri tejet të dobët të masave të planifikuara, gjë që vë në pah se reformat në

arsim po hasin në vështirësi dhe ka vonesa të theksuara.

Në përgjithësi masat e parapara në kuadër të këtyre dy pikave konsiderohen se kishin zbatueshmëri jo të kënaqshme dhe se lë të kuptohet se ritmi i zbatimit të masave që lidhen me arsimin por edhe me masat ekonomike kanë zbatueshmëri të ulët. Në vijim janë të paraqitura të dhënat e përgjithshme të zbatueshmërisë së masave në kuadër të këtyre pikave.

Pika 3.27 Kapitulli 26 të acquis-së: Arsimi dhe kultura përmbante gjithsej 5 masa: 2 masa legjislative (40%) dhe 3 masa zbatuese (60%) dhe niveli i zbatimit të këtij kapitulli është vetëm 20%, pasi që vetëm 1 nga 5 masat e planifikuara është zbatuar, ndërsa 80% e tyre (4 masa) nuk kanë arritur të zbatohen. *UA për kushtet dhe kriteret që drejton themelimin e formave duale të Arsimit dhe aftësimin profesional, në të cilën aftësimi paraprak dhe përvoja realizohen në ndërmarrje ishte njëra nga 4 masat e këtij kapitulli në kuadër të matricës së masave legjislative e cila nuk u realizua në vitin 2018. Ky udhëzim administrativ u hartua në fillim të vitit 2019. Për më tepër në këtë raport vlerësohet se “ky sektor përgjithësisht është përballur me vonesa serioze pasi që shumica e masave të planifikuara nuk janë realizuar”⁸*

⁷ Raporti mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2018: http://www.mei-ks.net/repository/docs/1_raporti_mbi_zbatimin_e_pkzmsa-se_gjate_vitit_2018_final.pdf

⁸ Ibid

Fig 1. Zbatimi i Kapitullit 26 të acquis-së: Arsimi dhe kultura



Edhe kapitull 2.2. *Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit* i cili në përgjithësi përmbante 5 masa kishte zbatueshmëri vetëm 20 % pasi që vetëm 1 masë është zbatuar plotësisht ndërsa 80 % e tyre nuk janë zbatuar. Edhe masat me ndikim në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional të parapara në kuadër të pikës 2.2 në PKZMSA 2018 nuk patën zbatueshmëri të nivelit të kënaqshëm.

Në pikën 2.2.2 dhe pika 2.2.3 në PKZMSA 2018 parashihen masa për *harmonizimin e ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave*. Në kuadër të kësaj objekteve në pikën 2.2.2 ishte paraparë rishikimi i kurrikulave të AAP për 20 profile dhe trajnimi

i 40 trajnerëve dhe mësimitdhënësve bazuar në kurrikulën bërthamë ndërsa pika 2.2.3 e kësaj objekteve planifikoi hartimin e *25 standardeve të profesionit të cilat verifikohen nga AKK*. Për të dy këto masa afati kohor i zbatimit ishte planifikuar katërmujori i 3-të i vitit 2018 dhe në fund që të dyja figurojnë si të pa zbatuara. Ky sektor poashtu u cilësua si me probleme të mëdha dhe me nivel të ulët të zbatueshmërisë së masave.⁹

⁹ Ibid



Fig 2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit



3.1 Zbatimi i Zbatimi i Agjendës për Reforma Evropiane ERA për Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Në Raportin Përfundimtar mbi Zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) 2016 – 2018 për pikën 3.6 që lidhet me përmirësimin e cilësisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë thuhet se pjesa dërmuese e masave të planifikuara nuk janë zbatuar. Nga 5 veprime sa janë të planifikuara vetëm 1 masë figuron si e zbatuar plotësisht ndërsa 4 masat tjera janë në zbatim e sipër.

Veprimi i vetëm i zbatuar është *a.1 Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (e bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë*. Ky është veprimi i vetëm i zbatuar për objektiven e përmirësimin të cilësisë AAP-së. Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit ka realizuar një raport vlerësues mbi sfidat

e përgjithshme të punësimit dhe thuhet se ky dokument dhe dokumentet tjera shfrytëzohen nga MASHT për hartimin e politikave. Në raport më tej thuhet se pranimi i nxënësve në shkolla profesionale është bërë duke i pasë për bazë kërkesat e tregut të punës si dhe se në disa raste është kërkuar hapja e profileve të reja në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës. Në bazë të këtij raporti të pazbatuara ende mbeten 4 masat tjera: *a.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësimin profesional përmes harmonizimit të AAP-së me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës, a.3 Hartimi i kurrikulave bërthamë për AA- së dhe fillimi i fazës së pilotimit, a.4 Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së dhe b.1 Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore.*

4. NDIKIMI I MASAVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL

4.1 Harmonizimi i legjislacionit dhe iniciativa për formën duale të arsimit

Aktualisht fusha e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional rregullohet përmes Ligjit nr. 04 /L-138 për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. Përveç këtyre në fuqi janë edhe 3 Udhëzime administrative përmes të cilave bëhet zbatimi i ligjit për arsimin profesional.¹⁰

Konsiderohet se ligji për arsimin profesional është vetëm pjesërisht i harmonizuar me Acquis në bazë të PKZMSA-2018-2022 ndërsa, në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 thuhet se “AAP administrohet përmes një numri të konsiderueshëm të ligjeve dhe politikave arsimore të cilat ndodhë të jenë kontradiktore dhe duhet të harmonizohen sa me shpejtë”¹¹

Duke marrë parasysh se harmonizimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së është ndër çështjet kyçe të Acquis, në PKZMSA të vitit 2018 për arsimin dhe aftësimin profesional ishte planifikuar vetëm një masë nën-ligjore.

UA për kushtet dhe kriteret që drejton themelimin e formave duale të Arsimit dhe aftësisimit profesional, në të cilën aftësimi paraprak dhe përvoja realizohen në ndërmarrje (plotësim ndryshim) ishte përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe për afat kishte katërmujorin e dytë të vitit 2018. Këtu duhet theksuar se i njëjti udhëzim administrativ ishte i paraparë edhe në PKZMSA të vitit 2017-2021, dhe për miratimin e këtij akti nën-ligjor ishte planifikuar katërmujori i tretë të vitit 2017.

Pasiqë PKZMSA 2018-2019 u publikua tek në muajin maj të vitit 2018 Departamenti Ligjor pranë MASHT-it në fillim të vitit deklaroi se nuk kishin ende të planifikuar ndonjë masë ligjore apo nënligjore për harmonizimin apo rregullimin e AAP-së dhe se sipas tyre kjo mund të ndodhë në gjysmën e dytë të vitit ku edhe u bart ky udhëzim administrativ.

Në bazë të Raportit për Zbatimin e PKZMSA-së gjatë vitit 2018 është po ky udhëzim administrativ që figuron në masat kyçe të planifikuara për vitin 2018 të cilat nuk kanë arritur të zbatohen. Në fillim të vitit 2019 kur u publikua edhe plani i ri për zbatimin e MSA-së thuhet se ky UA është hartuar dhe se pas shumë sfidave ka filluar bashkëpunimi me ndërmarrjet dhe se ky UA do të fillojë të zbatohet nga ky vit në ato shkolla dhe profile për të cilat ka kërkesa nga bizneset.¹²

10 Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2018-2022, faqe 271: http://www.mei-ks.net/repository/docs/20180731115427_1_pkzmsa_2018-2022_final_miraturar nga_kuvendi.pdf

11 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, faqe 27: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

12 Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2019-2023, faq 37: http://www.mei-ks.net/repository/docs/20190510083007_pkzmsa_2019-2023_final.pdf

Bashkëpunimi në mes të shkollave dhe ndërmarrjeve si formë për të mundësuar kalimin nga shkolla në punë por edhe për rritjen e cilësisë dhe shkathtësive të fituara ishte paraparë edhe në pikën b.1 të ERA-s. *Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore* si veprim ishte paraparë të përmbushet qysh në vitin 2017 ndërsa në raportin e vitit 2018 figuron si pikë e pa përmbushur e ERA-s. Në raport më tej thuhet se MASHT me mbështetje të projektit “EYE” ka pilotuar sistemin dual të mësimin në vend të punës në 4 shkolla profesionale në bashkëpunim me bizneset dhe se mbi këtë pilotim është hartuar udhëzimi administrativ i cili e rregullon mësimin në vendin e punës. Për më tepër, në raport thuhet se bizneset tani kanë mundësinë të bashkëpunojnë me shkollat në profesionet që ato kanë interes dhe të mundësohet puna praktike.

Në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë potencohet rëndësia e praktikës profesionale si në shkollë ashtu edhe në ndërmarrje pasi që kjo është forma e vetme që të rriten “mundësitë e kandidatëve për vetëpunësim, punësim, por edhe mundësitë për punësim në ato ndërmarrje ku përfundojnë praktikën.” Mes tjerash, në raport potencohen sfidat e mëdha për praktikën profesionale si në shkolla, si rezultat i mungesës së pajisjeve, por edhe në biznese, si mungesë e bashkëpunimit të mirëfilltë me sektorin e biznesit. Një arsye tjetër e potencuar në PSAK për mospërputhje të arsimit profesional me tregun e punës përmendet edhe fakti se “rreth 30% e shkollave profesionale ofrojnë profile të cilat nuk janë shumë të kërkuara në treg”¹³

Nga fokus grupin e organizuar nga Organizata Çohu më datën 20 mars 2019¹⁴ me Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional IAAP shumica u deklaruan se ndër problemet kryesore tek shkollat profesionale mbetet praktika profesionale. Thuaja se të gjithë pjesëmarrësit u deklaruan se praktika profesionale shumicën e rasteve realizohet nga vullneti i mirë i punëdhënësve e jo pse është pjesë e planprogramit të MASHT-it. Pra, deri më tani e vetmja mënyrë për punë praktike është krijimi

i kontakteve individuale të shkollave me bizneset dhe marrë parasyshë numrin e madh të nxënësve as kjo formë nuk siguron punën praktike për të gjithë. Bizneset e kanë problem të absorbojnë numrin e madh të nxënësve, andaj IAAP hasin në vështirësi të mëdha në regjistrimin e nxënësve për mbajtjen e punës praktike. Pra, bashkëpunimi me biznese ka shumë vështirësi dhe jo gjithnjë është i mundur. Edhe vetë zyrtarë të MASHT-it deklaruan se bizneset në Kosovë ende nuk janë në nivelin që ta kuptojë rëndësinë dhe përfitimet dypalëshe të një bashkëpunimi të tillë. Përjashtim sa i përket punës praktike kishin shkollat që nga donacionet përfituan makinerinë dhe pajisjet e nevojshme për punë praktike si dhe Qendrat e Kompetencës ku nxënësit mund ta përfundojnë pjesën praktike brenda institucionit shkollor.

Në përgjithësi shkollat u deklaruan se këto iniciativa për mësimin dual janë tepër të hershme dhe nuk korrespondojnë me gjendjen reale të shkollave, rrjedhimisht shumica e shkollave do të dështonin në këtë drejtim.

Që arsimit në Kosovë nuk korrespondojnë me nevojat e tregut të punës thuhet edhe në Raportin e Progresit të vitit 2019, për më tepër thuhet se “cilësia e arsimit ende mbetet të përmirësohet në masë të konsiderueshme” dhe se rekomandimet e vitit paraprak nuk janë adresuar fare.¹⁵

4.2 Standardet e profesionit, rishikimi dhe zbatimi i kurrikulave

Si proces tejet me rëndësi për harmonizimin e AAP-së me kërkesat e tregut të punës si dhe rritjes së cilësisë konsiderohet hartimi i standardeve të profesionit si dhe rishikimi dhe zhvillimi i kurrikulave sipas standardeve të profesionit. Përkundër rolit shumë të rëndësishëm kjo fushë ende mbetet një sfidë për shkak të numrit të kufizuar të standardeve të profesionit dhe rrjedhimisht edhe kurrikulave që korrespondojnë me standardet.

13 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, faqe 24: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

14 Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!, më 20 mars 2019 ka organizuar dhe mbajtur fokusgrup lidhur me sfidat në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional si dhe rolin e reformave në punën dhe cilësinë e IAAP. Materiali i gjeneruar nga ky fokus grup është pjesë integrale e tekstit.

15 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2019, faqe 76: <http://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>

Në PSAK 2017-2021 thuhet se rreth

30%

te shkollave profesionale ofrojnë profile të cilat nuk janë shumë të kërkuara në treg”

Duke qenë se së fundmi ka filluar edhe procesi i akreditimit të programeve të AAP-së, standardet e profesionit dhe kurrikulat janë thelbësore për akreditim. “Procedurat e akreditimit të programeve në AAP e definojnë qartë se të gjitha kurrikulat duhet të jenë modulare, të bazuara në kompetenca dhe me kritere të qarta vlerësimi. Kurrikula bërthamë për AAP duhet të përmbushë nevojat e sektorëve ekonomikë, dhe të shërbejë si udhërrëfyese për zhvillimin e standardeve të profesioneve dhe kornizave kurrikulare të profileve profesionale. Kurrikuli bërthamë për AAP duhet të ofrojë më shumë orë të praktikës profesionale, si dhe më shumë përmbajtje specifike të profesionit”, thuhet në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021.¹⁶ Në PSAK 2017-2021 thuhet se “rreth 30% e shkollave profesionale ofrojnë profile të cilat nuk janë shumë të kërkuara në treg”¹⁷

Pika 2.2.2 në PKZMSA për vitin 2018 kishte paraparë objektiven për *harmonizimin e ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave*. Në kuadër të kësaj objektivë në pikën 2.2.2 është paraparë rishikimi i kurrikulave të AAP për 20 profile dhe trajnimi i 40 trajnerëve dhe mësimdhënësve bazuar në kurrikulën bërthamë. Afati kohor i paraparë për përmbushjen e kësaj mase ishte katërmujori i 3-të i vitit 2018. Në anën tjetër, pika 2.2.3 e kësaj objektivë planifikoi hartimin e 25 standardeve të profesionit të cilat verifikohen nga AKK, dhe afati për përmbushjen e saj ishte planifikuar poashtu katërmujori i 3-të i vitit 2018. Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtyre dy masave ishte 100,000.00 Euro për standardet e profesionit dhe 21,900.00 Euro

për hartimin e kurrikulave dhe që të dy shumat ishin siguruar nga donacionet. Asnjëra nga këto pika nuk u realizua në vitin 2018 dhe rrjedhimisht edhe objektiva bazë figuron si e pa përmbushur.

Edhe në kuadër të ERA-s ishin paraparë veprime për harmonizimin e AAP-së me nevojat e tregut të punës. Pika a.2 në ERA parashihte “Përmirësimin e cilësisë së sistemit të aftësisimit profesional përmes harmonizimit të AAP me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës”. Kjo pikë nuk u zbatua sipas raportit për zbatimin e ERA-s edhe pse për afat të zbatimit kishte tremujorin e tretë të vitit 2017. Përkundër që kjo objektivë nuk u realizua në raport përmenden disa masa të ndërmarra nga MASHT në këtë drejtim siç janë hulumtimi në 68 shkolla profesionale, 8 qendra të aftësisimit të MPMS-së, dhe 4 ofrues privat të AAP-së për harmonizim me tregun e punës i cili ishte mbështetur nga GIZ.¹⁸

Poashtu në planin për zbatimin e ERA-s në kuadër të AAP-së ishte paraparë edhe pika a.3 *Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit*-veprim i cili poashtu figuron si i papërfunduar në raportin e fundit për zbatimin të ERA-s edhe pse afati për zbatim ishte paraparë qysh në tremujorin e dytë të vitit 2017. Në raport poashtu përmenden edhe hapat e ndërmarrë për realizimin e kësaj pike të planifikuar ku thuhet se është hartuar drafti i parë i Kornizës së Kurrikulës së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe se në dokument janë duke u adresuar komentet e palëve të interesit. Raporti poashtu thekson se janë identifikuar

16 Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, faqe 24: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

17 Ibid

18 Raport përfundimtar mbi zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) 2016 – 2018, faq 35: http://www.mei-ks.net/repository/docs/raporti_mbi_zbatimin_e_era_1_11_2016-30_11_2018.pdf

standardet për profesione të cilat do të hartohen apo rishikohen dhe pastaj do të vazhdohet me kurrikulat.¹⁹

Në fokus grupin e organizuar me IAAP²⁰ përfaqësuesit thanë se u ishte thënë që në shtator të vitit 2018 do të fillojnë punën me kurrikulën e re mirëpo, në mungesë të saj ata filluan punën në vitin e ri shkollor me kurrikulën e vjetër. Shumica e pjesëmarrësve u deklaruan se ende punojnë me kurrikula të vjetra por se sipas tyre nuk ka pasur fjalë të mira e as lëvdata as sa i përket kurrikulës së re nga shkollat të cilat kanë filluar të punojnë me të. Kishte edhe nga ata që konsideruan se tanimë është e dukshme se kjo kurrikulë po dështon dhe se MASHT duhet të tërhiqet nga ajo dhe të mos vazhdojë aplikimin e saj në shkolla tjera.

Të ngjashme ishin edhe deklaratat e përfaqësuesve të shkollave që tanimë kishin filluar punën me kurrikulën e re. Njëri nga ta u shpreh se kurrikula e cila përdoret në shkollën e tij është kurrikulë e dështuar, njëjtë sikur kurrikula bërthamë për shkollimin profesional, andaj ai tha se nëse do ta pyeste dikush, ai do të refuzonte përdorimin e kurrikulës së re. Të njëjtin mendim ndanin edhe përfaqësues të shkollave të tjera që punonin me kurrikulë të re duke shtuar se as këto kurrikulat nuk korrespondojnë me tregun e punës, madje u kishin krijuar mjaft vështirësi pasi që sipas tyre asnjë reformë nuk bëhet pa investime financiare, që lë të kuptohet se kostoja e implikuar në kurrikulat e reja mbetet e pa përballuar nga shkollat. Përkundër vështirësive ata u shprehën se janë të pafuqishëm të refuzojnë implementimin e saj kur një gjë e tillë kërkohet nga MASHT. Nga krejt këto mospërputhje sipas tyre tani ka lindur edhe dyshimi se a jemi duke e kuptuar se çka do të thotë fjala 'kurrikulë' kur vetë sistemi i ka lënë tri lloje kurrikulash në funksion.

Sipas tyre asnjë reformë e inicuar deri më tani nuk e ka pasur përfundimin e saj, duke i hutuar kështu përpjesëtarët nxënësve, edhe vetë personelin arsimor dhe ata që janë të involvuar në këtë proces. Sipas tyre sapa fillon një reformë, arsimtarët shkojnë në trajnime të

ndryshme lidhur me të, dhe në fund ajo reformë ndërprehet. Në këtë fokus grup u konstatua se problemi i këtyre reformave qëndron në faktin se çdo herë mundohen të importojnë ide të ndryshme nga shtete të ndryshme të cilat operojnë në rrethana plotësisht tjera nga ato që ekzistojnë në Kosovë.

Problem tjetër i theksuar në fokus grup ishte edhe hiperproduksioni në drejtime të caktuara ku sipas tyre ka profile që edhe po të mbyllen shkollat për vite të tëra do kishte kuadro të mjaftueshme të atyre profileve.

Në Raportin për Kosovën 2019 thuhet se programet e arsimit dhe aftësimin profesional (AAP) nuk kanë kurse praktike dhe aplikative, dhe se vetëm një numër i vogël prej tyre janë akredituar nga Autoriteti Shtetëror i Kualifikimeve. Për më tepër thuhet se Kosova duhet të rrisë cilësinë e programeve të AAP-së bashkë me kualifikimet dhe se duhet të zhvillohen programe të reja të cilat korrespondojnë me kërkesat në tregun e punës pasi që lidhja me tregun e punës konsiderohet tejet e dobët.²¹

Me profile që nuk korrespondojnë me tregun e punës, me reforma ende në fazë të hershme dhe me probleme të theksuara në zbatimin e tyre vërehet se edhe për një kohë të gjatë do të ketë hendek në mes të AAP-së dhe punësimit. Kur kemi parasysh se rreth gjysma e nxënësve në shkollimin e mesëm të lartë zgjedhin arsimin profesional dhe se shumë nga këto programe nuk janë relevante në tregun e punës atëherë mund të konsiderojmë se një numër i madh i nxënësve tanimë pjesë e procesit nuk do të kenë shkathtësitë e kërkuara, dhe rrjedhimisht edhe vështirësi që të qasen në tregun e punës.

Se cilësia e arsimit është tejet e ulët sipas Raportit për Kosovën e tregon raporti në mes të numrit të lartë të nxënësve të regjistruar, rezultateve të ulëta të PISA-s dhe papunësisë së lartë të të diplomuarve.²²

19 Ibid

20 Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohul, me 20 mars 2019 ka organizuar dhe mbajtur fokusgrup lidhur me sfidat në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional si dhe rolin e reformave në punën dhe cilësinë e IAAP. Materiali i gjeneruar nga ky fokus grup është pjesë integrale e tekstit.

21 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2019, faqe 76: <http://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>

22 Ibid

Në Raportin për Kosovën 2019 thuhet se

programet e arsimit dhe aftësimin profesional (AAP) nuk kanë kurse praktike dhe aplikative, dhe se vetëm një numër i vogël prej tyre janë akredituar nga Autoriteti Shtetëror i Kualifikimeve.

Duke marrë parasysh se rekomandimet e njëjta barten nga viti në vit edhe në fushën e AAP-së kërkohet zbatimi i rekomandimeve të pazbatuara nga vitet paraprake në këtë raport.

4.3 Menaxhimi dhe financimi i IAAP

Në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2022 thuhet se buxheti për nxënës në AAP është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat themelore. Për më tepër në raport thuhet se “shkollat publike profesionale kanë kufizime serioze në gjenerimin e të hyrave. Kufizimet financiare për AAP-në zvogëlojnë mundësitë për investime në infrastrukturë dhe në pajisje, edhe për ato aftësi specifike për të cilat ka një kërkesë në Kosovë.”²³

Në planin për zbatimin e ERA-s në pikën a.4 një ndër objektivat është edhe “Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së” pikë kjo e cila nuk u zbatua as në vitin 2018. Në raportin për zbatimin e prioritetëve të ERA-s përmenden edhe iniciativat e marra dhe që tregojnë se ky proces është ende në fazë goxha fillestare. Aty thuhet se “ është bërë analiza e kostos për disa profile (shëndetësi, ekonomi, dhe disa profile teknike) të cilat do ta plotësojnë formulën e financimit e cila do të zhvillohet, bazuar në Planin Strategjik të Arsimit 2017- 2021. Është bërë analiza e kostos së shpenzimeve për 2 vitet e fundit, për t'i krahasuar me shpenzimet e tanishme. Në muajin korrik janë mbledhur të

gjitha të dhënat për shpenzimet në shkollat profesionale nga thesari dhe janë duke u analizuar. Është duke u analizuar formula e financimit për arsim para universitar, në kuadër të së cilës analizë, parashihet edhe rishikimi i formulës për shkollat e arsimit profesional si pjesë e arsimit para universitar. Për këtë qëllim, është formuar edhe grupi punues me përfaqësues të Ministrisë së Financave.”²⁴

Në Raportin për Kosovën 2019 thuhet se përkundër faktit që shpenzimet publike të Kosovës për arsim janë në përputhje me vendet tjera me të ardhura mesatare, shpenzimet për nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm janë relativisht të ulëta dhe se kryesisht shpenzimet dominohen nga pagat për mësimdhënësit. Ndër të tjera përmendet edhe fakti se numri i nxënësve është shumë i lartë, përafërsisht dyfishi i mesatares së BE-së.

Financimi ishte sfida kryesore e theksuar nga të gjithë pjesëmarrësit e fokusgrurit të organizuar. Buxheti i ndarë për shkollat sipas tyre nuk është i mjaftueshëm për mbarëvajtjen e mësimin e lëre më për zhvillimin e ndonjë plani për shkollat. Sipas tyre ka raste kur shkollat fillore ka mjete të barabarta me shkollat profesionale pavarësisht që kjo e fundit përveç tjerash punon me material harxhues ku në disa raste nxënësit detyrohen vetë ta blejnë atë. Ka edhe nga ato raste kur shkollat deklarojnë se rreth 90% e buxhetit të alokuar për to shpenzohet për ngrohje. Njëra nga shkollat madje kishte llogaritur mjetet që iu mbesin në dispozicion për material harxhues pas mbulimit të shpenzimeve bazë e që ishte 11 centë për një orë mësimore për praktikë profesionale.

23 Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, faqe 27: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

24 Raport përfundimtar mbi zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) 2016 – 2018: http://www.mei-ks.net/repository/docs/raporti_mbi_zbatimin_e_era_1_11_2016_30_11_2018.pdf



Në Raportin për Kosovën 2019 thuhet se

përkundër faktit që shpenzimet publike të Kosovës për arsim janë në përputhje me vendet tjera me të ardhura mesatare, shpenzimet për nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm janë relativisht të ulëta dhe se kryesisht shpenzimet dominohen nga pagat për mësimdhënësit.

Ndër problemet kyçe që u përmend ishte sistemi i centralizuar i financimit ku disa nga shkollat nuk kishin mundësi të shfrytëzonin e as të kishin qasje në mjete që i gjeneronin vetë shkollat. Ata thanë se centralizimi i tanishëm është i tepërt, e ky nuk iu mundëson as përdorimin e mjeteve vetanake të cilat i gjeneron vetë shkolla, sepse këto mjete shkojnë në Ministrinë e Financave.

Sipas tyre formula e financimit të AAP-së duhet patjetër të ndryshohet dhe të decentralizohet pasi që procedurat që ata ndjekin në Departamentet Komunale të Arsimit (DKA) për marrjen e mjeteve janë të komplikuar, zgjasin shumë dhe kjo drejtpërsëdrejti ndikon në mbarëvajtjen e punës. Kjo sipas tyre ua pamundëson drejtorëve të shkollave të menaxhojnë dhe të krijojnë plane zhvillimore për institucionet që drejtojnë.

Bazuar në të gjeturat e këtij fokus grupi shumë shkolla kishin mungesë të pajisjeve për punë praktike. Ata përmendën se së fundi ka një gamë më të gjerë të donatorëve të interesuar për investim mirëpo, mungesa e komunikimit të shkollave me donatorët, për shkak të sistemit të centralizuar financiar, shpesh ndikon që fondet të mos korrespondojnë me nevojat dhe kapacitetet e shkollave.

Sipas tyre në disa shkolla ka pajisje të avancuara të cilat u siguruan përmes donacioneve mirëpo nuk përdoren pasi që stafi/mësimdhënësit nuk kanë njohuri të mjaftueshme për vënie në përdorim. Edhe pse theksuan rëndësinë e granteve, ata thanë se shkollat kryesisht përfitojnë pajisje e jo edhe mjete qarkulluese apo fonde për mirëmbajtje dhe rrjedhimisht mungesa e fondeve për mirëmbajtje të pajisjeve shpesh krijon situata që ato në pamundësi për t'u riparuar mbesin jashtë përdorimit.

Shfrytëzimi i sektorit të arsimit për qëllime të punësimit nga politika ishte edhe njëri nga problemet e theksuara. Ata theksuan se një gjë të tillë e mundësuan edhe eksperimentet me reforma të ndryshme ndër vite. Kishte edhe nga ato deklarata kur shkolla ishte detyruar të ndante paralelet përgjysmë në pamundësi për të reduktuar numrin e stafit. Një rast ilustrues ishte edhe shkolla e artit në Gjilan ku në shkollë ishin 3 nxënës dhe 13 profesorë.

Sipas tyre drejtorët e shkollave nuk e kanë fuqinë ekzekutive dhe si pasojë ndikimet nga jashtë janë të pashmangshme. Ata folën edhe për ndërhyrjet në regjistrimin e nxënësve në shkolla që ndikojnë në rritjen e numrit të tyre jashtë planifikimeve fillestare dhe se menaxhmenti i shkollave janë të pafuqishëm përballë këtyre ndërhyrjeve pavarësisht ndikimit negativ në cilësi por edhe në menaxhimin e përgjithshëm të shkollave profesionale. Përderisa disa shkolla deklaruan se kanë numër të lartë të nxënësve në disa shkolla problemi ishte e kundërta e kësaj. Shumë shkolla deklaruan se ka një numër të lartë të nxënësve që lëshojnë vendin dhe se ka rrezik që disa profile të shuhen për shkak të numrit të vogël të nxënësve.

4.4 Stereotipet në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional

Rreth gjysma e nxënësve që regjistrohen në arsimin e mesëm të lartë zgjedhin arsimin dhe aftësimin profesional, edhe pse sipas PSAK -ut viteve të fundit kjo shifër ka shënuar rënie. Shkollat që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional kryesisht konsiderohen si opsion i dytë nga nxënësit pasi që një status shumë më të lartë gëzojnë gjimnazet.²⁵ Kjo lë të kuptohet se në IAAP regjistrohen kryesisht nxënësit me nota më të dobëta. Këtë e konfirmuan edhe disa nga përfaqësuesit e IAAP në fokus grupin e organizuar, ku sipas tyre kanë ankesa edhe nga bizneset për shkathtësitë dhe aftësitë e nxënësve. Madje ata u deklaruan se në shkollat e tyre diplomohen edhe ata nxënës që kanë numër enorm të mungesave në mësim.

Këto shkolla përveç që nuk gëzojnë reputacion të mirë, ka ndarje të theksuara gjinore në profilet që ofrohen. Në përgjithësi numri i vajzave që vijojnë shkollimin e mesëm të lartë në IAAP është më i vogël. Madje në disa profile të cilat konsiderohen me relevancë për tregun e punës si në energjetikë, instalime elektrike, automekanikë, dirigjimin kompjuterik të makinave, transportit rrugor, trafik rrugor, tregti etj., vajzat thuaj se nuk i vijojnë fare.²⁶ E kundërt nga kjo, në profilet si rrob-aqepës, konfektioner, dizajn i tekstitit dhe veshjeve, kujdes social dhe shëndetësor janë disa nga profilet të ndjekura thuajse vetëm nga vajzat.²⁷ Nga ky trend i cili është prezent edhe në statistikat e profileve të punësimin vërehet se tregu i punës për gratë është zhvendosje e përgjegjësive dhe detyrave nga sfera private në atë publike.


- Sipas tyre formula e financimit të AAP-së duhet patjetër të ndryshohet dhe të decentralizohet pasi që procedurat që ata ndjekin në Departamentet Komunale të Arsimit (DKA) për marrjen e mjeteve janë të komplikuar, zgjasin shumë dhe kjo drejtpërsëdrejti ndikon në mbarëvajtjen e punës.

²⁵ Strategjia

²⁶ Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, "Të dhënat për periudhën gjatë pilotimit", faqe 28 <https://aaaparr.rks-gov.net/botimet>

²⁷ Ibid

Tab 3. Numri i nxënësve sipas profileve dhe gjinisë në ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në vitin shkollor 2016/2017



Në hulumtimin e Institutit Riinvest rezultatet e anketës tregojnë se gratë me profesionet më të paqëndrueshme janë: shitëset (me 32 përqind), floktare (me 19 përqind), rrobaqepëse (me 15 përqind), kuzhiniere (me 11 përqind), pastruese (me 7 përqind) dhe farmacistet (me 6 përqind).²⁸ Pra, profilet më të frekuentuara nga vajzat në shkollat profesionale figurojnë si profesione të paqëndrueshme në tregun e punës. Aktualisht gratë përballen me shkallë të lartë të papunësisë me rreth 40% por edhe me shkallë të lartë të joaktivitetit me 80%.²⁹


Sa i përket politikave promovuese dhe kampanjave që sfidojnë stereotipet gjinore në profesione pjesëmarr-

rësit e fokusgrurit u deklaruan se ka pak ose fare iniciativa në këtë drejtim. Ata përmendën “ditën e dyerve të hapura”, ku vijnë vajzat në shkolla profesionale në mënyrë që të shohin mënyrën e punës në këto shkolla, por megjithatë kjo sipas tyre është e pamjaftueshme andaj duhet bërë më tepër në promovimin e shkollave profesionale. Edhe në Planin e Veprimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë një ndër qëllimet në AAP ishte rritja e pjesëmarrjes së vajzave në drejtimet teknike.

Përkundër kësaj në vitin 2018 nuk pati ndonjë politikë në MSA me theks gjinor në arsimin dhe aftësimin profesional nga ana e MASHT. Në PKZMSA 2018-2022

²⁸ Institutit Riinvest, “Faktorët që ndikojnë në vendimet ekonomike të grave”, 2018: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2019/February/20/womens_economic_empowerment_ALB1550674286.pdf

²⁹ Ibid



në pikën 3.20. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi ishte paraparë një masë për rritjen 25% të numrit të grave të përfshira në masat aktive të tregut të punës, i rritur për 25% (nga 3,000 në 4,000). Përgjegjëse për përmbushjen e kësaj pike të planifikuar ishte Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës APRK ndërsa institucione ndihmëse ishin MASHT, MTI dhe MK.

Kjo masë është zbatuar dhe në kuadër të sajë sipas Raportit mbi Zbatimin e ERA-s thuhet se është “gjatë vitit 2017 rreth 35.4% apo në 3,181 raste të të ndërmjetësuarve përmes Zyrave të Punësimit për punësim të rregullt dhe masat aktive në tregun e punës kanë qenë gra. Përfshirja e grave në masat aktive të tregut të punës (subvencion në pagë, punë publike,

vetëpunësim, praktikant, trajnim ne punë dhe aftësim profesional) vetëm në gjashtëmuorin e parë të vitit 2018 është 2,042 përfituese.”³⁰

Me tej thuhet se analiza e pengesave të punësimin të grave të realizuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MSS), do të shërbejë si bazë për hartimin e politikave të punësimin dhe aftësimin profesional.

30 Raporti mbi Zbatimin e ERA-s, 2018, faq 30, http://www.mei-ks.net/repository/docs/raporti_mbi_zbatimin_e_era_1_11_2016-30_11_2018.pdf

5. REKOMANDIME

Të vazhdohet me reformat në AAP duke pasë për bazë kontekstin e vendit.

Të ketë matje të vazhdueshme të ecurisë së reformave që ato të shërbejnë në të mirë të cilësisë së AAP-së e jo të jenë një barrë më tepër për IAAP.

Të zhvillohet plan i detajuar për reduktimin e profileve pa relevancë në tregun e punës.

Të punohet në drejtim të decentralizimit financiar që IAAP të kenë mundësi të menaxhojnë mjetet sipas nevojës dhe planeve vjetore.

Të zhvillohen kampanja promovuese për AAP sidomos në profilet për të cilat ka kërkesa në tregun e punës.

Të gjinden forma për inkurajimin e vajzave në shkollim në profilet relevante me tregun e punës si dhe në profilet

ku ka pak ose fare vajza si rezultat i stereotipeve gjinore në profesione.



Ky grant financohet nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).